

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Telekom i Kosovës Sh.A.

Për Aktivitetin e Prokurimit: TK-26-871-1-1-1

Sa i përket tenderit për: "Furnizim me FWA CPE"

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**Cactus Sh.a.**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Rr. Bashkim Fehmiu 3 BC2/11 V1-Lo1-S**

(Adresa)

**Prishtinë**

**10000**

(Vendi)

(Kodi postar)

**+383(0) 38 600 488**

**N/A**

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

**z. Armend Malazogu-Drejtor Menaxhues**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**info@cactus.com**

(Adresa elektronike)

**14.04.2026**

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

\_\_\_\_\_  
*(Emri i avokatit)*

\_\_\_\_\_  
*(Adresa e plotë)*

\_\_\_\_\_  
*(Numri i Telefonit)*

\_\_\_\_\_  
*(Numri i faks-it)*

\_\_\_\_\_  
*(Adresa elektronike)*

\_\_\_\_\_  
*(Data e parashtrimt të ankesës)*

\_\_\_\_\_  
*(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

- Njoftimi për kontratë – 03.03.2026
- Kërkesa për informacione shtesë – 18.03.2026
- Sqarimet nga AK – 16.03.2026 dhe 25.03.2026
- Hapja e planifikuar e tenderit – 14.04.2026
- Kërkesa për Rishqyrtim - 07.04.2026
- Vendimi i AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim- 10.04.2026
- Parashtrimi i ankesës në OSHP- 14.04.2026

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po**

**Jo**

Ankesa parashtrohet ne fazën para hapjes se tenderit.

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

Jo

### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

Jo

*Vendimi i autoritetit kontraktues ne raport me kërkesën për rishqyrtim është refuzuar.  
Te bashkangjitur ne kete ankesë gjeni vendimin e ndërmarr nga Autoriteti kontraktues*

### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1 – Qëllimi  
Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti  
Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi  
Neni 28 – Specifikimet teknike  
Neni 108/A- Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve  
Neni 109- Afatet për Dorëzimin e Ankesës  
Neni 53- Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit

### 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

## I. KRONOLOGJIA E FAKTEVE DHE ANALIZA E ANKESËS

Në përputhje me nenet 108/A dhe 109 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), Operatori Ekonomik Cactus Sh.a. paraqet këtë ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK), me të cilin është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim dhe është lënë në fuqi njoftimi për kontrat për këte procedur të prokurimit.

Vendimi i AK-së është i pabazuar në fakte, i ndërtuar mbi interpretime formaliste dhe në kundërshtim me parimet themelore të LPP-së, përfshirë barazinë në trajtim, proporcionalitetin, konkurrencën e lirë dhe economicitetin.

Për më tepër, refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga AK karakterizohet nga:

- mungesë e arsytimit konkret dhe substancial,
- shmangie nga trajtimi i pretendimeve thelbësore,
- justifikime të përgjithshme dhe jo të mbështetura në prova.

Një qasje e tillë bie ndesh me parimet e transparencës dhe të administrimit të drejtë, duke e bërë vendimin e AK-së të cenueshëm nga pikëpamja ligjore.

## II. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E SHKELJEVE TË KONSTATUARA

Ankuesi ne kete rast ka ushtruar kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues (AK), duke ngritur shqetësime serioze lidhur me ligjshmërinë e specifikimeve teknike të përfshira në dosjen e tenderit. Kjo kërkesë është refuzuar në mënyrë të pabazuar, pa një trajtim të mirëfilltë dhe substancial të pretendimeve, çka përbën bazë të mjaftueshme për iniciimin e kësaj ankese pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Nga përmbajtja e dokumentacionit të tenderit dhe arsytimi formal i AK-së, rezulton qartë se AK ka vepruar në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, si në vijim:

- **Shkelja e Nenet 1 – Qëllimi i Ligjit**  
AK ka devijuar nga qëllimi themelor i ligjit, i cili garanton zhvillimin e një procedure të hapur, transparente dhe konkurruese. Përmes hartimit të specifikimeve të njëanshme dhe kufizuese, është cenuar drejtpërdrejt konkurrenca efektive dhe besimi në integritetin e procedurës së prokurimit.
- **Shkelja e Nenet 6 – Economiciteti dhe Efikasiteti**  
Vendosja e kriterëve teknike të panevojshme, joproporcionale dhe të paarsyetuara objektivisht ka kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, duke reduktuar konkurrencën reale. Si pasojë, AK ka dështuar të sigurojë përdorim efikas dhe ekonomik të fondeve publike, duke rrezikuar që kontrata të mos i jepet ofertës më të favorshme.
- **Shkelja e Nenet 7 – Barazia në Trajtim / Mosdiskriminimi**  
Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që krijojnë avantazh të padrejtë për operatorë të caktuar ekonomikë, duke vendosur kërkesa që nuk lidhen drejtpërdrejt me nevojat reale të kontratës. Kjo përbën trajtim të pabarabartë dhe diskriminues, në kundërshtim të hapur me këtë dispozitë ligjore dhe me parimet bazë të prokurimit publik.
- **Shkelja e Nenet 28 – Specifikimet Teknike**  
AK ka dështuar të hartojë specifikime teknike në përputhje me standardet ligjore,

të cilat kërkojnë që ato të jenë të qarta, funksionale, proporcionale dhe jo-diskriminuese. Në vend të kësaj, specifikimet janë formuluar në mënyrë të tillë që kufizojnë konkurrencën dhe de facto orientojnë procedurën drejt një operatori apo produkti të caktuar, gjë që është e ndaluar shprehimisht nga ligji.

- **Shkelja e Nenit 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**  
AK nuk ka trajtuar në mënyrë substanciale kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga Ankuesi, duke mos adresuar pretendimet thelbësore dhe duke ofruar arsyetim formalist dhe të përgjithshëm. Kjo përbën shkelje të detyrimit për shqyrtim efektiv dhe të paanshëm të kërkesave për rishqyrtim.
- **Shkelja e Nenit 109 – Afatet për dorëzimin e ankesës**  
Duke mos siguruar kushte reale për ushtrimin e të drejtës për ankesë brenda afatit ligjor prej 10 ditësh, përmes vazhdimit të aktivitetit të prokurimit pa zgjatje të afateve, AK ka cenuar të drejtën e Ankuesit për mbrojtje juridike efektive.
- **Shkelja e Nenit 53 – Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit**  
Përmes sqarimeve të dhëna dhe mënyrës së menaxhimit të procedurës, AK nuk ka garantuar transparencë dhe qartësi të mjaftueshme lidhur me kërkesat teknike, duke kontribuar në paqartësi dhe kufizim të konkurrencës, në kundërshtim me qëllimin e këtij neni.

### **III. KUNDËRSHTIM NDAJ ARSYETIMIT TË AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM**

Operatori Ekonomik “Cactus” Sh.a. kundërshton në tërësi arsyetimin e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, duke theksuar se vendimi është i bazuar në interpretime të gabuara ligjore, vlerësime faktike të pasakta dhe shkelje të rënda procedurale që kanë ndikuar drejtpërdrejt në vendimin e marr për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

Për më tepër, Ankuesi konsideron se Autoriteti Kontraktues (AK) ka qenë i obliguar që të vazhdojë pezullimin e aktivitetit të prokurimit dhe njëkohësisht të bëjë zgjatjen e afatit për dorëzimin e ofertave, së paku deri në përfundimin e afatit ligjor për paraqitjen e ankesave pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, konkretisht nenin 53, nenin 108/A dhe nenin 109, përcaktohet qartë e drejta e operatorëve ekonomikë që brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditësh nga data e pranimin të vendimit të AK-së mbi kërkesën për rishqyrtim, të ushtrojnë ankesë pranë OSHP-së. Ky afat përbën një garanci procedurale themelore dhe duhet të respektohet në mënyrë efektive, jo vetëm formale.

Në rastin konkret, duke mos e zgjatur afatin e dorëzimit të tenderëve dhe duke vazhduar me aktivitetin e prokurimit, AK ka cenuar drejtpërdrejt këtë të drejtë ligjore të operatorëve ekonomikë, duke e bërë praktikisht të pamundur ose të pakuptimtë ushtrimin efektiv të ankesës. Për më shumë AK në pjesën ku parashifet të ipet kjo këshillë juridike ka vu një shënim, i cili në vete shpërfaq të gjith procesin e paraparë për “Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve”.

Tutje, AK në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është thirrur gabimisht në nenin 63.1.1 të Rregullores, i cili parashihet se autoriteti kontraktues mund të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit duke vlerësuar arsyet e refuzimit dhe rrethanat konkrete të procedurës. Megjithatë, në rastin konkret, rrethanat faktike dhe afatet imperative ligjore

imponojnë një qasje tjetër – respektivisht, detyrimin për të mundësuar ushtrimin efektiv të të drejtës për ankesë.

Prandaj, interpretimi dhe zbatimi i nenit 63.1.1 nga ana e AK-së është bërë në kundërshtim me frymën dhe qëllimin e dispozitave ligjore të sipërpërmendura, duke anashkaluar të drejtën thelbësore të operatorëve ekonomikë për mbrojtje juridike efektive.

**1. Mospërputhja Teknike dhe Kontradikta "Bottleneck" AK ka refuzuar pretendimin tonë se kërkesa për agregimin e 4 brezave (4CC) në pikën 2.3(e) është në kontradiktë me ndërfaqen Wi-Fi 6 (2x2 MIMO) në pikën 3.3.**

- Sipas standardeve të IEEE, një ndërfaqe Wi-Fi 6 (2x2) ka një limit real prej 800-900 Mbps.
- Kërkimi i një hyrjeje prej mbi 1.5 Gbps (përmes 4CC) kur dalja nuk mund ta përcjellë atë shpejtësi te konsumatori, përbën blerje të "kapacitetit të fjetur" (Stranded Capacity).
- AK-ja në vendimin e saj nuk ka ofruar asnjë kundër-argument teknik, por vetëm ka deklaruar se "duhet të jenë sipas specifikimeve".

**2. Krijimi i Monopolit "De-Facto" (Favorizimi i Nokia-s)** Ne vërtetojmë se kombinimi kumulativ i kërkesave: **3GPP Release 17 + 4CC + Porta RJ11** është një matricë e personalizuar vetëm për portofolin e prodhuesit Nokia.

- AK-ja pretendon se "ka disa prodhues", por ka dështuar të specifikojë cilët janë ata, duke shmangur faktin se shumica e pajisjeve Release 17 të maturuara kanë eliminuar portën RJ11.
- Ky veprim shndërron prokurimin publik në furnizim të drejtpërdrejtë të maskuar.

**3. Paarsyeshmëria e Release 17 dhe Stabiliteti Termik** AK-ja insiston në Release 17, ndonëse në vitin 2026 kjo teknologji ka kosto 30% deri 50% më të lartë se Release 16, pa ofruar përparësi për shërbimet FWA.

- Pajisjet Release 16 janë standardi i maturuar që mbështet shpejtësitë gigabit dhe portën RJ11 me stabilitet maksimal.
- Agregimi i tepërt (4CC) në pajisje shtëpiake (Indoor CPE) rrit rrezikun e mbinxehjes ("Thermal Throttling"), duke shkaktuar rënie të shërbimit për 3,000 konsumatorët e Telekomit.

**4. Afati Joproportional për Dorëzimin e Mostrave** Përcaktimi i afatit prej vetëm 5 ditësh për dorëzimin e mostrave pas nënshkrimit të kontratës është fizikisht i pamundur për pajisje që kërkojnë prodhim dhe transport ndërkombëtar (Azi/Evropë).

- Ky proces (prodhim, transport, zhdoganim) kërkon minimum 21-30 ditë.
- AK-ja pohon se ky afat "mund të bëhet në dakordim me Menaxherin", por ky mbetet një diskrecion i rrezikshëm që lejon konfiskimin arbitrar të Sigurimit të Ekzekutimit.
- jo vetëm "është fizikisht e pamundur"
- por: "është kërkesë joproportionale, jo e arsyetuar me nevojën e kontratës, dhe me efekt dekurajues/kufizues ndaj operatorëve që nuk kanë stok lokal paraprak."

#### IV. PRETENDIMET ANKIMORE TË DETAJUARA

##### *PRETENDIMI 1: KONTRADIKTA "BOTTLENECK" (GRYKA E NGUSHTË) – AGREGIMI (3CC/4CC) VS. WI-FI 6*

Në pikën 2.3(e) të Dosjes së Tenderit (DT), kërkohet agregimi i 4 brezave (4-Carrier Aggregation / 4CC) si (n8+n1+n3+n78), teknologji që mundëson një rrjedhë të dhënash hyrëse mbi 1.5 Gbps. Ndërkohë, pika 3.3 kërkon Wi-Fi 6 me konfigurim 2x2 MIMO.

- **Analiza e "Bottleneck-ut":** Sipas standardeve teknike të IEEE, një ndërfaqe Wi-Fi 6 (2x2 MIMO) ka një limit fizik të transferit të të dhënave (Net Throughput) që në kushte reale shtëpiake (interferenca, muret, distanca) nuk kalon 800-900 Mbps.
- **Argumenti Teknik:** Kërkesa për 3CC apo 4CC (hyrje mbi 1 Gbps) është teknikisht e pakuptimtë kur ndërfaqja Wi-Fi e kërkuar (dalja) ka kapacitet më të ulët. Çdo shpejtësi që vjen nga rrjeti celular përmes 4CC do të mbetet e bllokuar brenda pajisjes, pasi Wi-Fi 6 2x2 nuk mund ta përcjellë atë te përdoruesi.
- **Efikasiteti i 2CC:** Një agregim prej 2 brezave (2CC), duke përdorur modulimin 256QAM (Pika 2.5) dhe 4x4 MIMO (Pika 2.4), është plotësisht i mjaftueshëm për të saturuar deri në maksimum ndërfaqen Wi-Fi 6 2x2 dhe për të arritur objektivin prej 1000 Mbps të kërkuar në pikën 2.9.
- **Implikimi Ekonomik:** Pagesa për licencat dhe hardware-in që mbështet 4CC përbën blerje të "kapacitetit të fjetur" (Stranded Capacity). Kjo dëmton buxhetin e AK-së për një performancë "fake" që konsumatori nuk do ta përjetojë kurrë.

**KËRKESA:** Të ndryshohet kërkesa dhe të lejohet agregimi 2-Carrier Aggregation (2CC).

##### *PRETENDIMI 2: RELEASE 17: KOSTO E LARTË, ZERO PËRFITIM DHE KONFLIKTI ME PORTËN RJ11*

Pika 2.1 kërkon pajisje 3GPP Release 17. Ky specifikim është i paarsyeshëm për tregun e vitit 2026:

- **Analiza e Maturisë (Prill 2026):** Me hyrjen në treg të pajisjeve Release 18 (5G-Advanced), Release 17 ka mbetur një fazë tranzitore me kosto të lartë. Për shërbimet FWA, Release 16 është vërtetuar si standardi më i qëndrueshëm, që ofron të njëjtën performancë gigabit por me kosto 30% deri në 50% më të ulët.
- **Cikli i Jetës:** Duke pasur parasysh se cikli i një pajisjeje CPE është 3 deri në 5 vite, insistimi në Release 17 sot është investim i paarsyeshëm. Deri në momentin kur rrjeti të kërkojë këto veçori, pajisjet do të jenë në fund të ciklit të tyre, duke e bërë këtë kosto një humbje të pastër financiare.
- **Stabiliteti i Softuerit:** Përvoja tregon se Release 16 është standardi i maturuar që mbështet shkëlqyeshëm shpejtësitë gigabit dhe portën RJ11, duke eliminuar gabimet (bugs) dhe mbinxehjen që karakterizojnë pajisjet hibride Rel-17.
- **Konflikti me RJ11 (Pika 3.5):** Shumica e pajisjeve moderne Release 17 janë "Pro-Grade" dhe kanë eliminuar portën fizike RJ11 (fokusuara te VoNR). Duke insistuar në Rel-17, AK eliminon pajisjet e maturuara që integrojnë telefoninë fikse (kërkesë e detyrueshme në pikën 3.5).

**KËRKESA:** Të ndryshohet kërkesa në "3GPP Release 16 ose më lart".

### *PRETENDIMI 3: STABILITETI TERMIK DHE RREZIKU I "THERMAL THROTTLING"*

Në pikën 2.4 kërkohet 2Tx (Uplink MIMO) në bandën n78, kërkesë të cilën e mbështesim. Megjithatë, kërkesa kumulative për agregim 3CC/4CC krijon rreziqe:

- **Mbinxehja:** Agregimi i 3 ose më shumë brezave në një pajisje të brendshme (Indoor CPE) rrit në mënyrë eksponenciale konsumin dhe nxehtësinë. Kjo detyron procesorin të aktivizojë "Thermal Throttling", që ul automatikisht shpejtësinë për të mbrojtur hardware-in, duke shkaktuar rënie të papritura të shërbimit.
- **Argumenti Final:** Insistimi në 3CC/4CC nuk shton vlerë reale pasi shpejtësia kufizohet nga Wi-Fi (Pretendimi 1), por rrit shkallën e dështimit (Failure Rate) për shkak të stresit termik.

**KËRKESA:** Të lejohet agregimi 2-Carrier (2CC) si standard i mjaftueshëm.

### *PRETENDIMI 4: KUFIZIMI I KONKURRENCËS DHE MONOPOLI DE-FACTO (PIKA 1.4)*

Kombinimi i kërkesave (Release 17 + 4CC + RJ11 + CE) ka krijuar një barrierë teknike të pakalueshme:

- **Favorizimi i Prodhuesit:** Konstatohet se kjo matricë specifikimesh është hartuar në mënyrë të izoluar dhe të personalizuar vetëm për portofolin e produkteve të prodhuesit **Nokia**, duke tentuar të krijojë një monopol të detyruar.
- **Shkelja e LPP-së:** Ky veprim bie ndesh me parimet bazë të prokurimit që kërkojnë specifikime jo-diskriminuese. Hartimi i specifikave që i përshtaten vetëm një modeli specifik të Nokia-s privon Telekomini nga çmimet më të favorshme të tregut.
- **Rreziku i Certifikimit:** Pajisjet hibride që pretendojnë këtë kombinim janë shpesh në fazë testimi dhe rrezikojnë të mos posedojnë certifikimin CE (RED & EMC) në momentin e dërgesës, duke rrezikuar bllokimin e importit.

**KËRKESA:** Të lejohet Release 16 dhe agregimi 2CC për të garantuar konkurrencë të mirëfilltë.

### *PRETENDIMI 5: AFATI PËR DORËZIMIN E MOSTRAVE (KUSHTET E VEÇANTA)*

Afati prej 5 ditësh për dorëzimin e mostrave pas kërkesës së menaxherit të kontratës është i paarsyeshëm:

- **Rreziku i Sigurimit të Ekzekutimit:** Dështimi për të dorëzuar mostrat brenda një afati teknikisht të pamundur (5 ditë) ekspozon Operatorin ndaj konfiskimit të Sigurimit të Ekzekutimit. Ky rrezik dekurajon operatorët seriozë.
- **Pamundësia Objektive:** Pajisjet FWA CPE nuk janë produkte stoku lokal; ato prodhohen dhe konfigurohen pas konfirmimit të porosisë. Procesi (prodhimi jashtë vendit, transporti, zhdoganimi) kërkon një minimum prej 21 deri në 30 ditë.
- **Favorizimi i Brendit:** Ky kusht favorizon vetëm një operator që mund të ketë akses të menjëhershëm në stoke të gatshme të pajisjeve Nokia, duke shërbyer si kriter eliminues "de-facto" dhe duke shkelur Nenin 7 të LPP-së.

**KËRKESA:** Afati për dorëzimin e mostrave të zgjatet në së paku 30 ditë kalendarike.

**PRETENDIMI 6:** Shkelja e të drejtës për ankesë dhe moszgjatja e afateve procedurale nga Autoriteti Kontraktues

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke mos respektuar detyrimin për të garantuar ushtrimin efektiv të të drejtës së ankesës pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).

Sipas nenit 53, nenit 108/A dhe nenit 109 të Ligjit për Prokurimin Publik, operatorëve ekonomikë u garantohet e drejta që brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditësh nga pranimi i vendimit mbi kërkesën për rishqyrtim, të paraqesin ankesë pranë OSHP-së. Ky afat përbën një garanci thelbësore procedurale dhe duhet të respektohet jo vetëm në aspekt formal, por edhe në mënyrë efektive dhe praktike.

Në rastin konkret, AK, duke mos pezulluar aktivitetin e prokurimit dhe duke mos zgjatur afatin për dorëzimin e ofertave, ka cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë këtë të drejtë ligjore, duke e bërë ushtrimin e ankesës joefektiv dhe praktikisht të pamundur. Veprime të tilla bien ndesh me parimet e transparencës, barazisë dhe garantimit të mjeteve efektive juridike në procedurat e prokurimit publik.

Tutje, AK në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është thirrur gabimisht në nenin 63.1.1 të Rregullores për Prokurim Publik, i cili i jep mundësi autoritetit kontraktues të vazhdojë aktivitetin e prokurimit në varësi të rrethanave të rastit. Megjithatë, në rastin konkret, rrethanat faktike dhe afatet imperative të përcaktuara me ligj imponojnë detyrimin për të siguruar mundësinë reale dhe efektive të ushtrimit të së drejtës së ankesës, duke përfshirë edhe pezullimin e aktivitetit apo zgjatjen e afateve të tenderimit.

Rrjedhimisht, veprimet e AK-së përbëjnë shkelje procedurale materiale që cenojnë të drejtën e garantuar ligjore të operatorëve ekonomikë për mjet juridik efektiv.

## **VI. PËRFUNDIMI**

Nga të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura më sipër, rezulton qartë se Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me parimet dhe dispozitat themelore të Ligjit për Prokurimin Publik.

Specifikimet teknike të hartuara në dosjen e tenderit janë joproportionale, teknikisht kontradiktore dhe ekonomikisht të pajustificueshme, duke krijuar një “bottleneck” funksional, duke imponuar kërkesa të panevojshme si Release 17 dhe 4CC, si dhe duke vendosur kushte që nuk përputhen me realitetin e tregut dhe nevojat reale të shërbimit FWA.

Për më tepër, kombinimi kumulativ i këtyre kërkesave teknike (Release 17 + 4CC + RJ11) rezulton në kufizim të drejtpërdrejtë të konkurrencës, duke krijuar një situatë monopoli de-facto dhe duke favorizuar operatorë apo prodhues të caktuar, në kundërshtim me parimin e barazisë në trajtim dhe konkurrencës së lirë.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues ka dështuar të respektojë të drejtën e ankuesit për mbrojtje juridike efektive, duke mos pezulluar procedurën dhe duke mos zgjatur afatet në

përputhje me nenet 53, 108/A dhe 109 të LPP-së, çka e bën procesin të cenueshëm edhe nga aspekti procedural.

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim është bërë pa një analizë substanciale të pretendimeve, me arsyetim të përgjithshëm dhe formalist, duke mos adresuar çështjet thelbësore teknike dhe ligjore të ngritura nga ankuesi.

Në tërësi, veprimet e Autoritetit Kontraktues përbëjnë shkelje të drejtpërdrejta të nenit 1, nenit 6, nenit 7, nenit 53, nenit 108/A dhe nenit 109, e në veçanti të nenit 28 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dispozita kyçe që rregullon hartimin e specifikimeve teknike, si dhe njëkohësisht paraqesin cenim të parimeve themelore të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë në prokurimin publik.

## VII. KËRKESA PËR OSHP

Duke u bazuar në sa më sipër, në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe në të drejtën për mbrojtje juridike efektive, Ankuesi propozon që Organi Shqyrtues i Prokurimit të nxjerrë këtë:

### VENDIM

1. **Të aprovojë ankesën** e Operatorit Ekonomik Cactus Sh.a. si të bazuar;
2. **Të anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues** mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, si të kundërligjshëm dhe të pabazuar;
3. **Të konstatojë se specifikimet teknike të dosjes së tenderit janë diskriminuese, joproportionale dhe në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së**, si dhe me parimet e nenit 1, 6 dhe 7 të LPP-së;
4. **Të urdhërojë Autoritetin Kontraktues** që:
  - të korrigjojë specifikimet teknike në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe konkurrencës së lirë;
  - të eliminojë kërkesat kufizuese dhe joracionale;
  - të harmonizojë kërkesat teknike me nevojat reale dhe standardet e tregut;
5. **Të urdhërojë pezullimin e aktivitetit të prokurimit**, në mënyrë që të mundësohet zhvillimi i një procedure të rregullt dhe ligjore;
6. **Të obligojë Autoritetin Kontraktues të zgjatë afatet përkatëse**, për të garantuar ushtrimin efektiv të të drejtës për ankesë dhe pjesëmarrje të barabartë në procedurë;
7. **Të ndërmarrë çdo masë tjetër ligjore** që e vlerëson të nevojshme për rivendosjen e ligjshmërisë në këtë aktivitet të prokurimit, e së paku:
  - anulimin e vendimit mbi refuzimin e rishqyrtimit,
  - urdhërim për korrigjim të specifikimeve kufizuese,
  - ripublikim / zgjatje të afatit pas korrigjimit të dosjes.

Si Operator Ekonomik, jemi të gatshëm të ofrojmë çdo informacion dhe provë shtesë që mund të kërkon për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Përveç shkeljeve të konstatuara më parë, ne gjithashtu jemi të dëmtuar nga shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes së kërkesës për rishqyrtim, si dhe ankesës.

- kosto për analizë teknike të dokumentacionit,
- kosto administrative/juridike për rishqyrtim dhe ankesë,
- humbje e mundësisë reale për pjesëmarrje efektive në procedurë,
- cenim i interesit legjitim ekonomik për të konkurruar në kushte të barabarta.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*